

# Probleme aktuale të baletit tonë

Panajot Kanaçi, Agron Aliaj

Artistë të merituar

**K**arakterit kombëtar i baletit merr një rëndësi të veçantë në krijimin e veprës artistike koreografike ashtu si në çdo lloj dhe gjini tjetër të artit tonë socialist. Baleti ynë, përveç përmbajtjes socialiste revolucionare, duhet të jetë i gjithi shqiptar, me koloritin ose intonacionet shqiptare, i mbështetur në gurrën e pashtershme të folklorit tonë muzikor dhe koreografik. Kjo mbështetje ndikon shumë në vërtetësinë e veprës, ndihmon që të shmangët çdo pasqyrim irreal i historisë dhe i jetës së njerëzve tanë.

Partia vazhdimisht ka theksuar domosdoshmërinë e origjinalitetit të artit tonë. «Arti ynë - tha shoku Enver në Plenumin e 4-t të KQ të Partisë, - me përmbajtje socialiste dhe revolucionare, ka vulën kombëtare, shpreh ndërgjegjen e popullit tonë në momentet e mëdha historike që kemi kaluar dhe po kalojmë».

Për këtë qëllim, është synuar që baleti ynë t'u shmangët temave që nuk i përshtaten aktualitetit, si atyre me përralla apo temave sentimentale, që trajtohen veçanërisht në baletet e huaja. Duke nxjerrë mësim nga fjala e shokut Enver e 20 dhjetorit 1974 dhe duke u thelluar në problemet e koreografisë na dalin detyra të rëndësishme.

Mendimi ynë krijues duhet të jetë gjithmonë në kërkim të realitetit tonë, të synojë plotësimin e nevojave të masave punonjëse, për ta bërë artin tonë koreografik një armë politike dhe ideologjike për edukimin e njeriut tonë të ri.

Shqipëria është vend i valleve të mrekullueshme popullore, i një arti folkloristik të mahnitshëm. Populli ynë, para dhe pas betejës, ka kërcyer me optimizëm dhe me forcë emocionale të rrallë. Në çdo gëzim e fitore vallja ka qenë bashkudhëtare e jetës së tij. Larmia e artit folkloristik është jashtëzakonisht e pasur, ashtu siç është e pasur bota shpirtërore e këtij populli, historia e tij. Prandaj, jo më kot masat e duan dhe e respektojnë artin koreografik dhe baletet tona kombëtare.

Duke pasur përvojën pozitive të baletëve tona kombëtare, është e nevojshme të nxjerrim konkluzione. Duhet thënë se puna e deritanishme e krijuesve tanë ka bërë që të ruhen gjithnjë tiparet e shëndosha të bazuara në intonacionet tona kombëtare. Principet e ndjekura këtu janë edhe fryt i zbatimit në praktikë të eksperiencës më përparimtare dhe më të shëndoshë të artit koreografik botëror, duke iu larguar gjithnjë me konsekuencë rrymave të ndryshme të huaja.

Në balet, përveç disa elementëve kryesorë të tij si muzika, koreografia, dekori, kostumet, rëndësi të dorës së parë ka dramaturgjia, e cila i jep veprës jo vetëm formën emocionale, por edhe ndikon mjaft në ngritjen e nivelit artistik të atyre elementëve kryesorë. Kjo dramaturgjia, që nën-

kupton konflikte të qarta, dramaticitet, rrjedhshmëri ngjarjesh e ndeshje kontradiktash në subjektin e veprës, lidhet në radhë të parë me temën dhe idenë që ka shfaqja e baletit. Ajo duhet të ketë në qendër ndeshjen për jetë a vdekje të popullit tonë që ka luftuar në të kaluarën gjithnjë për liri; të ketë në qendër jetën e popullit tonë sot, që punon për ndërtimin e socializmit, për formimin e njeriut tonë të ri etj. Këto të vërteta historike duhet të jepen në dramaturgjinë e libreteve të baletëve nëpërmjet marrëdhënieve të personazheve, episodeve, ngjarjeve kuptimplotë, që të dalin në çdo veprim e në çdo skenë me forcë të madhe artistike.

Për këtë është e nevojshme që dramaturgu të bashkëpunojë shumë më tepër me koreografin, sepse, në disa raste, njëri, duke mos njohur specifikën e baletit, dhe tjetri veçoritë e dramës, arrijnë në vepra të mangta e të njëanshme.

Suksesi i një veprë baleti varet shumë, pra nga libreti, i cili duhet të ketë në vetvete vlera të shumta artistike dhe një bagazh të konsiderueshëm të veprimit dramatik. Në qoftë se nisemi nga një libret i dobët, muzika, qoftë edhe shumë e bukur, do të paraqesë një mendim të cekët, koreografi do të mundohet e nuk do të gjejë frymëzim për të krijuar një veprë dinjitoze dhe emocionale, dekori do t'i vihet si sfond një ideje jo të thellë.

Shpesh është shprehur mendimi se shkrimtarët «si njohin proble-

met e baletit». Por, po të lichen më mirë me jetën dhe të bashkëpunojnë më shumë me koreografët dhe kompozitorët, veprat e tyre do të dalin të mira. Për këtë qëllim në qendër të këtij bashkëpunimi të kiheq parasysih specifika e artit koreografik.

Në karakterin kombëtar të baletit, rol kryesor luan muzika, sepse kompozicioni muzikor është baza e dramaturgjisë së veprës koreografike. Në ndonjë rast kompozitorët marrin si shembull trajtimin muzikor të baletëve të huaja, qoftë kjo në daret, në variacionet, vallet etj. Ky imitim e dëmton baletin tonë në karakterin e tij kombëtar. Sipas mendimit tonë, kjo mund të arrihet në qoftë se kompozitorët dhe koreografët, kur ulen për të shkruar një balet, largohen nga disa forma klasike të dueteve, façedëve e të tjera, sepse përdorimi në baletet tona i tyre e çon koreografinë në ato vështirësi që nuk mund të arrijnë rezultate për të mishëruar figurën artistike me ato mjete shprehëse që do të dëshëronin atë. Por dëshira për të arritur duetin thjesht, me mjete shprehëse të bazuara në lëvizjet tona kombëtare, do të arrihet atëherë, kur kompozitori do të nisë nga forma e gjetur në impulsin shpirtëror ritmik të njerëzve shqiptarë, duke e kërkuar formën në ato të valles së popullit, ashtu siç është bërë deri më sot shumë mirë në skenat masive. E tërë kjo do të krijojte atë unitet stil, të nevojshëm në baletin tonë kombëtar. Kësi-

tu, në koreografët do ta kemi më të lehtë që edhe mjete shprehëse koreografike t'i kërkonim nga burimi i pashtershëm i valleve popullore. Pra, do të pasuronim gjuhën koreografike të personazheve tona, duke u larguar edhe më shumë nga elementët klasikë të përsëritura në çdo balet dhe që sjellin varfërinë dhe monotoninë në gjuhën shprehëse koreografike. Në këtë mënyrë baleti ynë do të marrë një fizionomi më origjinale, do të pëlqehet edhe më shumë nga masat.

Por për forcimin e mëtejshëm të karakterit kombëtar të baletit tonë një rol të rëndësishëm luan edhe pasurimi i vazhdueshëm i formave dhe i mjeteve artistike koreografike që duhen përdorur për të pasqyruar idetë tona revolucionare. Shoku Enver Hoxha, në fjalën e tij të 20 dhjetorit 1974, midis të tjerave thotë: «Teatri ynë, qoftë ai dramatik, qoftë ai i operës dhe i baletit, kanë fituar eksperiencë dhe kanë krijuar një traditë, por asnjëherë nuk duhen pushuar përpjekjet për të gjetur mjete dhe mënyra të tjera më të reja e më frymë revolucionare për ta pasuruar dhe për ta bërë më të përsosur këtë eksperiencë dhe traditë».

Në funksion të kësaj kërkese duhet, së pari, të thellohem në përpunimin me një karakter simfonik të valles sonë popullore, sepse kemi mjaft mungesa për muzikën e valles së përpunuar.

Gjithashtu nuk duhet synuar vetëm për vepra të mëdha me dy-tre akte. Shfaqje të ndryshme të jetës sonë mund të trajtohen fare mirë edhe në vepra me një akt, me dy tablo etj.

Arti, si shprehje e ideologjisë, zhvillohet në përputhje me idetë që ai trajton, krijon premisa për të gjetur mjete shprehëse të reja që të mund të pasqyrojnë sa më qartë këto ide. Si mund të arrihet kjo? Trajtimi i puntëve (qëndrimi në majë të gishtave) në

(vijon në f. 11)



Pamje nga baleti «Cuca e maleve».